



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 45**

Datë: 09. 07. 2021. Ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Florian Dushi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuviq, Rifat Krasniq, Fazli Stollaj

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni ; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**3. Këshillat e KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit Operacional të Sigurisë së KQZ-së për zgjedhjet lokale 2021,
- Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të vizitave të KQZ-së në komunitat e Republikës së Kosovës,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit për zgjedhjet lokale 2021.

- Njoftim me aktivitetet e draft planit të trajnimit për zgjedhjet e lokale 2021.
- Njoftim lidhur me specifikimet teknike për materialet zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021:
  - Për furnizimin me UV sprej,
  - Për furnizim me UV llampa,
  - Për furnizim me bateri 1.5 v për UV llampa.
- Shqyrtimi dhe miratimi i emërimeve plotësuese dhe zëvendësimi për anëtar të KKZ-ve për zgjedhjet lokale 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi i agjendave të punëtorive:
  - Për përmirësimin e listës së votuesve,
  - Për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ne mes te KQZ-se dhe PZAP-it.
- Shqyrtimi dhe miratimi raportit të Konfirmimit të dhënave nga ZLKZ-të, Departamenti i Pensioneve/Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,

**5. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik.**

**6. Njoftim lidhur me buxhetin e alokuar të Subvencioneve.**

**7. Të ndryshme**

**1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**

**Kreshnik Radoniqi:** Përsëndetje, e fillojmë mbledhjen e 45-të. Rendin e ditës e keni, na mungon procesverbali i mbledhjes së fundit...

**Burim Ahmetaj:** Për shkak të kohës së shkurtër në mes të dy mbledhjeve, procesverbal nuk është sjellë në këtë takim, kurse kemi si propozim tri pika që të jenë në rendin e ditës, sepse të njëjtat, nuk kanë mundur të shqyrtohen në KOZ, dhe për këtë nevojitet vendimmarrje:

- Plotësimi dhe emërimi plotësues i anëtarëve të KKZ-së për zgjedhjet Lokale 2021.
- Shqyrtimi dhe miratimi i agjendës për punëtorinë që do të mbahet më 13, dhe 16 korrik.
- Shqyrtimi dhe miratimi i konfirmimit të të dhënave nga Zyrtarët Komunal që lidhet me Departamentin e Pensioneve dhe Personat e Vdekur.

**Kreshnik Radoniqi:** Këto propozime janë te KOZ-i...

**Sami Kurteshi:** E kam një çështje teknike, na është dërguar materiali por unë s’kam mundur ta hapë materialin dhe unë, jam i papërgatitur...Ju lutem që, postimet dhe gjitha informacionet, dokumentet në formën e zakonshme që hapen me programet e zakonshme...

**Alim Rama:** Po i referohem draft agjendës sepse, ajo e dërguar me imel dhe kjo në letër, nuk korrespondojnë sepse, nuk është një pikë, ajo për aplikacionin...! Neve, duhet të na jepet mundësia të diskutojmë, sepse edhe Sekretariati ka nevojë t’i jepet mundësia për diskutim. Dhe, jo t’i ikim përgjegjësisë, apo t’i shmangemi... Po ashtu, ndoshta në të ndryshme diskutojmë, por unë nuk jam i kënaqur me përbërjen e këshillave...

**Florian Dushi:** Ne, diskutojmë për këshillat, përbërjen e tyre. Kështu, ne kemi nisur të kemi problem me këshillat sepse, ne diskutojmë agjenda partiake jashtë asaj çfarë merremi vesh në KQZ, dhe prandaj takimi i sotëm i KOZ-it nuk ka arritur të mbahet. Problemi nuk është me “aplikacionin” siç, provon me e paraqitur kolegu, por problemi është me mënyrën e paraqitjes së rendit të ditës...

Pra, zotimi publik yni është ai që ka qenë, pra mbetet publik dhe ne ia kemi drejtuar Sekretariatit dhe jo z. Rama me futë në agjendë çfarë të dojë ai, prandaj kërkesa jonë ka qenë që Sekretariati ta sjellë në KQZ një raport rreth mundësisë së përgatitjes së aplikacionit dhe, implementimit të të njëjtit. Kjo, nuk ka qenë që të diskutohet në KOZ ! Ndërkohë, z. Rama në cilësinë e kryesuesit të KOZ-it, e ka futur në agjendë...

Edhe unë jam kryesues i një këshillit, por dihet s’i krijohen agjendat...! Pra, ka qenë pikë e imponuar, por le të thotë kryeshefi nëse ai e ka propozuar, ose le të na thotë se mundemi me ecur përpara me aplikacionin, ok...unë, jam për...

Prandaj, tha z. Dushi, edhe unë propozoj që po, ta kemi pikë të veçantë funksionimin e këshillave...!

**Arianit Elshani:** E tha edhe kolegu se ne kemi shprehur pakënaqësinë me udhëheqjen e KOZ-it, ku qartazi është parë tendenca për të imponuar agjenda politike brenda rendit të ditës...Që të mos përsëritëm, tendencat e këtilla duhet të ndalen brenda KQZ, veçmas në këshilla ku bëhen planet operacionale...Dhe, kjo ka qenë një pakënaqësi nga ne. Kurse, tendenca për ti vendosur edhe tri pika pa u shqyrtuar, unë

mendoj se këto nuk duhet të diskutohen, sepse paraprakisht, duhet të shqyrtohen paraprakisht në këshilla...Ky është një precedent pastaj, sepse pikat që Sekretariati po i propozon, duhet të shqyrtohen në këshilla...

Po vërehet që, këshillat kështu siç janë, nuk janë funksionale por po vërehet edhe mungesa e dy anëtarëve të pa plotësuar të KQZ-së, dhe e përsëris edhe njëherë urgjencën e plotësimit të këtyre dy vendet nga presidenca..

Ne e dimë se, tha z. Elshani se para vetes do të kemi pika në shqyrtim dhe miratim që kërkojnë 2/3 e miratimit nga anëtarët e KQZ-së, pra shumicën kështu që, mendoj se për shkak të dallimeve tona mund të kemi vështirësi...

**Kreshnik Radoniqi**, kërkoi që të arsyetohet propozimi i Sekretariatit për futjen në agjendë të tri pikave të reja...

Krye shefi **Burim Ahmetaj**, arsyetoi propozimet e Sekretariatit duke konsideruar se, të tri pikat janë të arsyeshme dhe, rekomandojmë që ato të futen në agjendë...

**Kreshnik Radoniqi**: Sa di unë, në KOZ e keni trajtuar planin operacional të Sigurisë së KQZ-së për zgjedhjet lokale 2021, draft planin e vizitave të KQZ-së në komunat e Republikës së Kosovës, gjithashtu, pastaj shqyrtimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit, edhe kjo është trajtuar më herët, Draft planin e trajnimeve, dhe specifikat teknike për materialet zgjedhore ku hyjnë UV spreji, UV llampat dhe bateritë 1.5 v për UV llampa...

Pikë së pari, të votojmë lidhur me këto! A po pajtohem për këtë agjendë pa tri propozimet, pastaj i votojmë tri plotësimet tjera...?

Kush është për rendin e ditës, pa propozimet e z. Ahmetaj ?

Me shtatë (7) vota për, dhe dy ( 2 ) abstenime, miratohet rendi i ditës.

**Kreshnik Radoniqi**: Kush është për tri propozimet e parashtruara nga Sekretariati që të trajtohen sot në rendin e ditës së këtij takimi ?

Me gjashtë ( 6 ) vota për, dhe tri (3) abstenime, miratohen këto propozime të Sekretariatit.

**Kreshnik Radoniqi**: Miratohen, kurse raportin e Këshillit Mbikëqyrës, do ta trajtojmë në "Të ndryshme".

## **2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati, vazhdon të përgatitet për të filluar me aktivitetin e operacionit përmes postës, përkatësisht periudhën e aplikimit për t'u regjistruar si votues jashtë vendit. Divizioni i trajnimit, është duke përgatitur programin orientues për anëtarët e Këshillave Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) të cilët janë emëruar së fundi nga Komsioni Qendror i Zgjedhjeve. Programi orientues planifikohet të zhvillohet nga data 14 dhe 15 korrik, i ndarë në seanca dhe ka për qëllim që KKZ të njihet me detyrat, përgjegjësitë, planin operacional si dhe me procesin zgjedhor në tërësi.

Në aspektin procedural, tha z. Ahmetaj, Sekretariati ka identifikuar të gjitha ndryshimet që do të përfshihen në procedurat e votimit dhe numërimit si dhe me dizajnimin e formave zgjedhore, në mënyrë që të njëjtit të jenë në përputhje me ndryshimet që propozohet të bëhen. Është përgatitur draft ndryshimi i procedurave dhe tani Sekretariati është në përgatitjen e dizajnit të formave dhe të gjitha ndryshimet e propozuara do të rekomandohen KQZ-së për aprovim, para se të fillojë trajnimi mbi procedurat e votimit, numërimit dhe trajnime tjera që ndërlidhen me format zgjedhore.

Ndërsa në aspektin procedural të përgatitjeve, para se të fillojë operacioni, është përgatitur lista me e-mail te të gjithë votuesve të cilët kanë pasur të drejtë të votojnë me postë dhe do t'u dërgohet e-mail gjatë ditës së premtë, për të konfirmuar se a dëshirojnë të votojnë përmes postës. Së bashku me tekstin në e-mail, do tu dërgohet Formulari të cilin duhet ta plotësojnë, duke i'a bashkangjitur edhe kopjen e një dokumenti valid. Të gjithë votuesit që nuk konfirmojnë, do të kthehen në listën përfundimtare të votuesve.

Sa i përket hapësirës, përgatitjet për funksionalizimin e sallës B202 në objektin e Ministrisë së Infrastrukturës janë drejt finalizimit, përfshirë rregullimin e hapësirës, instalimin e kompjuterëve dhe pajisjeve përcjellëse për të operuar. Hapësira do të monitorohet nga kamerat brenda dhe jashtë sallës B202.

**Sami Kurteshi,** lidhur me këtë raport, kërkoi shpjegim në "paragrafin e 2-të, pasuesi i fundit" rreth "votuesve" që votojnë jashtë Kosovës, pra në kontekst me "dërgimin e imelave" dhe eventualisht, me mos konfirmimin e tyre....Më saktë, këta nëse nuk e konfirmojnë marrjen e imellit, "kthehen" në listën përfundimtare...

**Burim Ahmetaj,** shpjegoi se të gjithë votuesit që janë regjistruar s'i të suksesshëm për të votuar jashtë vendit apo përmes postës, e ku janë rreth 102 mijë votues, të gjithëve: do t'u dërgohet ftesa për të marrë pjesë në zgjedhje. Nga ky numër, të gjithë ata që nuk e konfirmojnë pjesëmarrjen, të gjithë ata do të

kthehen në “Listën Përfundimtare të Votuesve”, sepse nuk kemi konfirmim nga ana e tyre, dhe nuk kemi të drejtë t’i heqim nga lista përfundimtare e votuesve...

Kjo bëhet, tha z. Ahmetaj që ta kemi të konfirmuar “Listën e Votuesve Jashtë Vendit” të të gjithë atyre që aplikojnë...

**Sami Kurteshi**: Këta persona, a janë në listën e votuesve që e merr KQZ, pra pse këta tash duhet të kthehen në listë...?

**Burim Ahmetaj**: Me vendim të KQZ-së, të gjithë këta persona janë hequr nga lista brenda vendit, dhe këta rreth “102” mijë votues, figurojnë në “listën e votuesve jashtë vendit” !

Tani, ata që nuk e konfirmojnë pjesëmarrjen, ata kthehen “në listën brenda vendit” dhe ata, kanë të drejtë të votojnë në listën e brendshme...

**Sami Kurteshi**: Nëse ata janë në listën e Republikës së Kosovës, pse këtyre personave që janë jashtë duhet me ju dërguar “102” mijë imella, kur ata janë në listë ! Pse ata nuk mundën me aplikue, veç me e ndërrua vendvotimin...? S’ka nevojë t’u dërgohet imel...Kjo, është pyetja ime...! Krejt kjo punë, është në lehtësinë e aplikacionit...

**Burim Ahmetaj**: Ne, i kemi procedurat e veprimit...! Kjo procedurë që ne e përdorim, është miratuar nga KQZ...

**Florian Dushi**: (Një pjesë e diskutimit, nuk është e regjistruar...)...Pavarësisht se ne e kemi një listë të vjetër të votuesve nga jashtë – nga zgjedhjet paraprake, në listën e re të votuesve ata figurojnë në listë... Por ne, KQZ, shfrytëzon një “listë të vjetër” të votuesve me postë për të kërkuara nga ata (dërgimi i “102” mijë imelave nuk është obligim ligjorë por si lehtësim nga institucioni ynë), nëse të njëjtit do të votojnë me postë. Përndryshe, lista është e integruar...! Ne, në këtë fazë e kemi listën, por e kemi edhe një listë paraprake që na mundëson me e ditë se, kush janë votuesit që votojnë nga jashtë vendit...

Në këtë fazë, nuk ka ndarje të votuesve, brenda dhe jashtë...

**Alim Rama**: Raporti, është jo shumë shpjegues ! Ne, e kemi pranuar një listë me qytetarët me të drejtë vote... ( 1 milion, e mbi 800 mijë votues), ku përfshihen edhe këta “102” mijë: të gjithë ata që janë shtetas të Kosovës... Nuk kthehet “kërkush – kërkund” ! Këtu, është edhe qëllimi për aplikacion, se “të gjithë ne që jetojnë brenda Kosovës” kemi mundësi me e ndryshua vendvotim, kemi një aplikacion që e trajtoj listën e votuesve, kemi mundësi me ndërrua vendvotim (prej pikës A, në pikën B), kudo qoftë – brenda qytetit...

Qëllimi i aplikacionit ka qenë, tha z. Rama, që me u trajtua qytetarët barabartë, të gjithë me pas të drejtë, edhe me i lehtësua sa ma shumë procedurat, me e lehtësua procesin...

Si KQZ, ne jemi duke bërë diskriminim, sepse nuk ju japim qasje të barabartë të gjithë qytetarëve të Kosovës... Aplikacioni, ekziston në KQZ. Krejt çka ka pasur nevojë, ka qenë me u krijua edhe një vendvotim i ri që thirret "vendvotim jashtë Kosovës". Imeli që dërgohet, dërgohet vetëm me i njoftua, ata konfirmojnë por përsëri ata aplikojnë me procedurë të vjetër...

Edhe Sekretariati, ka problem me e shpjegua, sepse oëpron në mënyrë të gabuar. Sa për informacion, në zgjedhjet e fundit, ne i kemi pasur 151 000 imejla...janë shtyp me miliona copë letra, janë bërë shpenzime të panevojshme, janë shkelë të drejtat e shumë qytetarëve për shkak të problemeve teknike...

Kërkoj që pika e aplikacionit, serish të kthehet në KQZ...

### **3. Këshillat e KQZ-së:**

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

#### **1.Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit Operacional të Sigurisë së KQZ-së për zgjedhjet lokale 2021:**

**Alim Rama:** Në këshill, është trajtuar plani i sigurisë ku, parashihen të gjitha mënyrat, segmentet operative të sigurisë, koordinimi me të gjitha segmentet relevante. E kemi drafitet. Plani, është në formë standarde. Një shpjegim, lidhet me vëzhguesit, sepse në zgjedhjet e kaluara ka pasur probleme ku policia ka ndërhy, kurse tani qasja e vëzhguesve do të bëhet pa pengesa...

Në mënyrë unanime, plani është aprovuar në KOZ, prandaj ne rekomandojmë për t'u miratuar ky plan.

Lidhur me këtë pikë, **Sami Kurteshi**, tha se nga të gjitha raportet e brendshme dhe të jashtme, kemi pasur momente në QV dhe VV, ku komisionarët dhe vëzhguesit janë frikësuar të rrinë aty, fjala është për 4 komunat në veri, gjithsesi...Unë kërkoj që të mos ketë në asnjë QV dhe VV ku, ndonjë person, goftë votues, vëzhgues, komisionarë të ketë frikë pjesëmarrje...

Kjo, të jetë në vëmendje të veçantë që çdo personi të i garantohet lëvizja e lirë, votimi i lirë...

Florian Dushi: Ne, po ndërlidhem me këtë, e kemi diskutuar në KOZ dhe jemi pajtuar, pavarësisht se nuk ka pasur raste të theksuara që, plani i sigurisë, përmbajtja, memorandumet të përfshijnë formulime të qarta...që, roli i policisë, i vëzhguesve dhe i të gjithë atyre që angazhohen si bartës të

procesit, secili operacion dhe çdo gjë tjetër, t'i nënshtrohet vëzhgimit dhe sigurisë dhe kjo, është edhe me ligj...

Këto elemente, edhe janë të theksuara në plan, dhe do të përfshihen në memorandumit e bashkëpunimit...

Miratohet...

## **2. Shqyrtimi dhe miratimi i draft planit të vizitave të KQZ-së në komunat e Republikës së Kosovës:**

**Alim Rama:** Këshilli, e ka shqyrtuar draft planin e vizitave të KQZ-së në komuna, dhe këto vizita në parim janë në shërbim të planit zgjedhorë...Disa data të cekura, nuk janë korrigjuar dhe se, ato le të korrigjohen nga Sekretariati...

Dhe, me këtë korrigjim, KOZ, rekomandon për miratim.

Miratohet, me propozimin për ndryshim në datat e vizitave.

## **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Qendrave të Votimit për zgjedhjet lokale 2021:**

**Alim Rama:** Këshilli, po ashtu ka shqyrtuar edhe miratimin e Qendrave të Votimit. Ne, obligohemi t'i shpallim, ndonëse pak më herët se zakonisht...! Në anën tjetër, në zgjedhjet e kaluara ne kemi pasur 888 QV, ndërsa në këto zgjedhje kemi 883 QV...

Z. Rama, shpjegoi arsyet se, pse në këto zgjedhje ka më pak QV, domethënë ai tregoi se ku dhe pse, janë zvogëluar QV-të...

Këshilli, tha z. Rama, ka pranuar kërkesën e ndryshimeve të QV-e nga KKZ-të e Prishtinës, të KKZ të Gracanisës, të KKZ të Obiliqit, të KKZ-së të Skenderajt, dhe të KKZ të Fushë Kosovës...

**Florian Dushi:** Sa për korrektësi, 1 vendvotim ose 2 (Prizren) nuk janë pranuar sepse, nuk kanë pasur arsyeshmëri të pranueshme...

Miratohen rekomandimet e KOZ-it, me 8 vota për, dhe 1 abstenim.

## **4. Njoftim me aktivitetet e draft planit të trajnimit për zgjedhjet e lokale 2021:**



**Alim Rama:** Këshilli, ka trajtuar edhe draftin e trajnimit. Ky, është vetëm njoftim...! Ne, presim që aktivitetet e trajnimit, të zhvillohen sipas planit operacional...

#### **5. Njoftim lidhur me specifikimet teknike për materialet zgjedhore për zgjedhjet lokale 2021:**

**Alim Rama:** Kjo pikë, është vetëm pikë njoftuese lidhur me furnizimin me UV sprej, UV llampa dhe me bateri për UV llampa. Këto materiale, nuk janë përfshirë në specifikat e kaluara, sepse është thënë se, të hulumtohen materialet – teknologjitë e reja, mirëpo Sekretariati mund ti shfrytëzoj të gjitha materialet që mund të përdoren teknikisht...nëse janë në rregull...

#### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i emërimeve plotësuese dhe zëvendësimi për anëtar të KKZ-ve për zgjedhjet lokale 2021:**

**Burim Ahmetaj:** Kjo pikë e propozuar nga ne, ka të bëjë emërimin dhe plotësimin e zëvendësimit për anëtar të KKZ-ve, sepse nuk kanë arritur me kohë të bëhen për shkak se disa anëtarë i janë nënshtruar verifikimit nga KGJK, dhe një pjesë tjetër është dashur të plotësohen nga shoqëria civile...dhe së fundi, i kemi edhe dy zëvendësime që i keni të prezantuara në tabelën e poshtme...

Pra, tha Ahmetaj, janë edhe disa vende të zbrazëta që jemi në pritje nga subjektet politike, dhe një nga OJQ...

Rekomandimi ynë është që, s'i "një listë" e përbashkët të miratohet...

**Sami Kurteshi:** Ky është plotësimi i KKZ-ve, e di ! A ka pasur raste të ankesave...?

**Burim Ahmetaj:** Ka pasur në komunën e Gjilanit, dhe e njëjta ankesë është parashtruar në PZAP, dhe për këtë, e kemi edhe vendimin që ankesa është hedhur poshtë...por, jemi në pritje të zëvendësimit...

**Kreshnik Radoniqi:** Pse nuk e kemi vendimin e PZAP-së ?

**Sami Kurteshi:** Tash, a duhet ta presim edhe vendimin e Gjykatës Supreme...?

**Burim Ahmetaj:** Po, jemi në pritje të vendimit të KGJK-së, mirëpo ne paraprakisht, e kemi informuar subjektin...

**Fazli Stollaj:** Te dorëheqjet e të dy anëtarëve të KKZ-ve ( në Gjakovë dhe në Rahovec ), unë po besoj se do t'ju jepet mundësia që të zëvendësohen, dhe pastaj ata të miratohen këtu në KQZ. Apo jo...?

**Burim Ahmetaj:** Në Gjakovë, është bërë zëvendësimi, mirëpo jo edhe në Rahovec. Në të njëjtën kohë, e kemi dërguar edhe ftesën që të bëhet zëvendësimi...

**Kreshnik Radoniqi:** E hedh në votim nominimin e anëtarëve të KKZ-ve !

Miratohen me vota unanime

#### **5. Shqyrtimi dhe miratimi i agjendave të punëtorive:**

**Burim Ahmetaj:** Në kuadër të planit të punës, janë dy aktivitete që përkrahen nga OSBE: 1. Aktiviteti për përmirësimin e listës së votuesve. 2. Aktiviteti për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ne mes te KQZ-se, dhe PZAP-it.

Sipas planifikimit të donatorit, janë dy data: 13 korrik, lokacioni nuk është i definuar saktë, dhe tjetri, më 16 korrik. Para vetës, e keni agjendën...

Në këtë pikë, diskutuan: Arianit Elshani, Alim Rama, Burim Ahmetaj.

Miratohet agjenda për mbajtjen e dy punëtorive.

#### **6. Shqyrtimi dhe miratimi raportit të Konfirmimit të dhënave nga ZLKZ-të, Departamenti i Pensioneve/Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:**

**Burmi Ahmetaj:** Fillimisht, po i sjell disa informata bazike. Më datë 29 shtator 2020, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përkatësisht nga departamenti i Pensioneve, kemi pranuar “listën” e përpunuar që nga viti 2000 – 2020, që tregon numrin e personave të hequr nga marrja e pensionit, pasi që të njëjtit, pas periudhës obligative “gjashtëmujore” nuk e kanë konfirmuar praninë e tyre fizike për vazhdim të pensionit...

Të dhënat nga kjo databazë MPMS-së, Sekretariati i ka analizuar dhe shqyrtuar. Data baza, fillimisht ka përmbajtur 135, 792 persona. Krahasimin, ne e kemi bërë me ekstraktin Civil, dhe nga 129, 174 persona, 23, 648 persona ka rezultuar se, kanë qenë në mesin e të gjallëve në Regjistrin Civil...

Kështu, tha z. Ahmetaj 105, 526 persona, janë larguar si të vdekur nga Regjistri Civil. Pra, nga krahasimi që kemi bërë, ka mbetur që edhe më tej, të bëhet verifikimi i “23, 648” personave që nuk e kanë shfrytëzuar pensionin.

Më datën 2 tetor 2020, Sekretariati këtë shifër e ka ndarë dhe e ka dërguar në 37 komuna në mënyrë që këta pasona, të verifikohen. Lista, është dërguar në Zyrat e Gjendjes Civile, në Bashkësitë Lokale Fetare dhe, është verifikuar edhe përmes përfaqësuesve të Fshatrave...

Me këto metoda, e kemi bërë verifikimin. Për rrjedhojë, s’i të vdekur janë konfirmuar “13, 728” persona. Janë verifikuar se ende jetojnë “807” persona, dhe nuk ka qenë e mundur që të verifikohen “9005” persona. Ndërsa, “111” persona, nuk kanë qenë banorë rezidentë në komunat përkatëse...

Janë tabelat pasqyruese për çdo detaj të mëtejshëm...!

Sekretariati, ka dy propozime për vendim: shqyrtimi dhe miratimi i raportit përfundimtar, pra konfirmimi i të dhënave nga data – baza e zyrtarëve komunalë, dhe marrja e vendimit nga ana e KQZ –së për largimin nga lista e votuese të 3254 votuesve që, janë konfirmuar si të vdekur nga verifikimi i zyrtarëve komunal...Këta, rekomandojmë me vendim të largohen nga lista e votuesve...

Në këtë pikë, folën: **Sami Kurteshi**, i cili shtroi pyetje sidomos, nëse periudha “gjashtëmujore” e mos lajmërimit të personave që marrin pension, të jetë kriter që ndonjë person të futet në “listën e të vdekurve”. Pyeti po ashtu se, si janë konfirmuar si të vdekur “3254” persona! Pra, kush – qysh në Republikën e Kosovës, sipas cilës procedurë shpallet i vdekur...?

**Burim Ahmetaj**, u përgjigj në pyetjet e parashtruara, si dhe **Beznik Buzhala**, zëvendës kryeshef përmes shpjegimit të procedurave, të dhënave, statistikave etj.

**Arianit Eshani**, pyeti nëse ka marrje të listës nga MPMS gjatë këtij viti ? dhe po ashtu, shtroi edhe pyetje të tjera rreth statistikave të marra, dhe analizimit e shfrytëzimit të të dhënave të marra...

Sërish, **Sami Kurteshi**, shtroi dilemën nëse, lista që vjen nga Agjensoni i Regjistrat Civil, mund të mos jetë krejt e saktë, ndonëse ky agjencion është kryesori...

Në këtë pyetje, u përgjigj **Besnik Buzhala**, i cili tha se, verifikimet janë në vazhdim e sipër dhe se Sekretariati, vazhdon ta përmirësoj listën votuese...

Në këtë pikë, diskutoi edhe: **Alim Rama**, i cili kërkoi një plan veprimi bashkë me ARC-në, **Gordana Llaban** e cila pyeti se cili është veprimi i KQZ-së...**Florian Dushi**, i cili tha se ajo që pranohet nga ARC mund të mos

jenë krejt të sakta, por problemet janë në terren, mirëpo largimet që i bënë KQZ janë vetëm për këto zgjedhje...E rikujtoj Sekretariatit që, nëse ARC ka një listë unike – të integruar të personave që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës, dhe mendoj se edhe kjo kategori nuk e ka vendin në listën e votuesve...

**Kreshnik Radoniqi:** I hedh në votim të dy këto rekomandime.

Martohen këto rekomandime, me një ( 1 ) votë abstenimi

#### **7. Njoftim nga Këshilli Mbikëqyrës i Informimit Publik:**

**Fazli Stollaj:** Këshilli, më datën 8 korrik, janë shqyrtuar dy dokumente që ndërlidhen me periudhën e aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës. Dokumenti përmban 11 pyetje që e shpjegojnë, apo japin informacione të mjaftueshme se si të aplikohet, dhe mbi të drejtat e aplikimit dhe regjistrimit...Përgjigjet, janë të lidhura edhe me Udhëzimin Administrativ që e kemi miratuar, dhe ata që aplikojnë, mund edhe të verifikohen...

Dokumenti i dytë, ka të bëjë me miratimin e tekstit për informim për periudhën e aplikimit për regjistrim për votuesit jashtë Kosovës. Ky tekst, do të përdoret në spote dhe videospote, në reklama, në portale dhe rrjete sociale...

Teksti për informim, do të publikohet në ueb faqen e KQZ-së, në ueb faqet dhe rrjetet sociale të komunave, në rtk 1, 2 dhe 3. Si dhe në mjetet e tjera të informimit dhe në rrjetet sociale, si dhe i njëjti material do t'u shpërndahet ambasadave dhe konsullatave të Republikës së Kosovës, dhe subjekteve politike...

#### **8. Njoftim lidhur me buxhetin e alokuar të Subvencioneve:**

**Burim Ahmetaj:** Ju informoj lidhur buxhetin e alokimit të subvencioneve për korrik, gusht dhe shtator. Pra, qeveria e Kosovës, për shkak të rishikimit të buxhetit ka bërë alokimin e mjeteve për muajin korrik. Sekretariati ka bërë listën, dhe aty janë edhe ndalesat e gjobave në bazë të vendimit të KQZ-së. Është e specifikuar, mënyra se si do të ndalohen gjobat për subjektet të cilave, u janë shqiptuar...

E keni tabelën e buxhetit, alokimin, ndalesat...!

Alim Rama, tha se buxheti, subvencionet etj., trajtohen në këshilla, pra pse kjo nuk ka ndodhë ? Pse ka ardhur direkt në KQZ...? Mbi të njëjtën çështje, kërkoi shpjegime edhe Arianit Elshani.

**Burim Ahmetaj:** Kemi këso raste në fillim të muajit, deri sa të miratohet buxheti nga Kuvendi. Qeveria e Kosovës, ndanë me këste për secilin muaj, dhe e njëjta me këst, ndahet edhe tani...Ky, është kësti mujorë për subnencione...Për këtë, edhe po ju informojmë për muajin korrik dhe për muajt tjerë. Deri në miratimin e buxhetit, kështu do të jetë...

**Alim Rama:** NE, nuk po e kundërshtojmë në parim mënyrë, por mos respektimin e procedurave, ligji është i qartë, prandaj kjo është dashur paraprakisht të shqyrtohet në këshillin për buxhet...

## **7. Të ndryshme !**

Në të ndryshme, u diskutua për funksionimin e këshillave të KQZ-së, dhe u propozua që të diskutohet edhe mbi një rregullore lidhur me procedurat e organizimit dhe mbajtjes së mbledhjeve të KQZ-së. Gjithashtu, u kërkua edhe një raportim nga ZRPP lidhur me informacionet e aplikimit të subjekteve politike për zgjedhje etj.

Lidhur me çështjen e këshillave, **Florian Dushi** tha se gjendja aktuale e këshillave, interferohet nga mungesa e dy anëtarëve të KQZ-së, mirëpo tha ai, problemi qëndron tek funksionimi i këshillave që, kjo është e rregulluar jashtëzakonisht mirë se s'i, rregullohen këshillat... Pra, në transparencë të plotë, mund ta kemi edhe një orarë të mbajtjes së takimeve të këshillave, agjendën e përpilimit të këshillave...

**Alim Rama**, tha se këshillat, nuk e pasqyrojnë proporcionin e përbërjes së anëtarësisë së KQZ-së të dalë nga zgjedhjet e kalarua...

**Kreshnik Radoniqi**, tha se nuk duhet të diskutojmë më tutje mbi këtë çështje, të presim plotësimin e anëtarëve të KQZ-së. Çështja e funksionimit, besoj është e përcaktuar mbi bazë të rregulloreve... Pra, është e rëndësishme që të gjithë ta respektojmë rregulloren...

**Ibrahim Selmanaj**, tha se këshillat do të funksionojnë po me ne, prandaj t'i presim edhe ardhjen e dy anëtarëve të rinjë...Formati ndryshon, por këshillat duhet të funksionojnë dhe, kompromisi është i nevojshëm...

Lidhur me çështjen e rregullores së mbajtjes së mbledhjeve, ajo ekziston shprehimisht...!

**Alim Rama**, kërkoi që në relacion me komunikimin-informimin, Sekretariati të përdorë mënyrat e lehta teknike, në mënyrë që të mos kemi probleme në hapjen e imelave...

**Vesa Xharra**, e cila e përfaqësoi ZRPP-në në mbledhje, me kërkesën e Arianit Elshanit, paraqiti një raport të shkurtër rreth aktiviteteve të zyrës në mes të dy mbledhjeve. Zyra, e informoi KQZ-në se deri më tani, janë pranuar deri më tani tri aplikime të subjekteve politike. Ndërsa, nuk është pranuar asnjë aplikim për vëzhgim të zgjedhjeve...